

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHITJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU</b>
---	---	--

**C-I.-12-0054**

Përfaqësuar nga [REDACTED], avokat  
[REDACTED]

*Paditësi*

Kundër

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rr. Ilir Konushevci 8, Prishtinë**

Përfaqësuar nga avokat [REDACTED]

*E paditura*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji I, i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Qerim Fazliji, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 27 mars 2013, lëshon këtë:

### **Aktgjykim**

#### **Padia refuzohet si e pabazuar**

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

E paditura është duke privatizuar Ndërmarrjen e Re [REDACTED]. Pas dy tenderëve të dështuar, më 20 prill 2012 u shpall një njoftim i tretë ndërkombëtar i tenderimit. Sipas Rregullave të Tenderit të aplikueshme, të gjithë ofertuesit e interesuar janë të obliguar që të para kualifikohen para se të dorëzojnë ofertat e tyre. Neni 7.2 i Rregullave të Tenderit parashkruan:

*Secili ofertues i mundshëm duhet t'i ofrojë Agjencisë dëshmi të dokumentuara, siç janë të specifikuar në formularët e bashkangjitur ne Shtojcën E, deri në atë masë që sipas zgjedhjes së Agjencisë të jenë të pranueshme, se Ofertuesi i mundshëm i plotëson kriteret në vijim:*

- a) *Se ai ose Kompania Vartëse duhet të ketë përvojë në zhvillimin, menaxhim dhe operacione me hotele dhe/ose Qendra ILIXHE me një qarkullim vjetor minimal prej 3 (tre) milion EUR për se paku secilën nga 3 vitet e fundit dhe minimum 20% të ardhurave duhet të vijjnë nga aktivitetet e ILIXHES për së paku tri vite të njëpasnjëshme,*
- b) *Personeli kryesor: Ekspert në Menaxhment të Lart me së paku 10 vite përvojë në menaxhim/operacione në së paku dy projekte të ngjashme (hotel/ilixhe) dhe eksperti kryesor mjekësor me së paku 10 vite përvojë në mjekim me rehabilitim/terapi.*

*Në rast se Ofertuesi i mundshëm ka Kompani Vartëse ashtu si është definuar në Nenin 1 të definicionit mbi Kompaninë vartëse në këto Rregulla të tenderit, Ofertuesi i mundshëm duhet t'i sigurojë Agjencisë një kopje të një instrumenti me shkrim dhe ligjërish detyrimor që rregullon marrëdhëniet e Ofertuesit të mundshëm me asi lloj kompanie vartëse, dhe ai dokument duhet të përmbajë informacionet që thirren në nën/nenet (a)-(d) të Nenit 1 të definicionit mbi Kompaninë vartëse.*

Neni 1 i Rregullave të Tenderit përcakton se

***Kompania vartëse nënkupton cilëndo korporatë ose entitet biznesi të cilën:***

*(1) Ofertuesi i mundshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi e posedon dhe të cilën gjithashtu e kontrollon ose (b) është në pronësi ose nën kontroll të Ofertuesit të mundshëm. Për qëllim të këtij definicioni kuptimi i fjalës “posedon” duhet të nënkuptojë pronësi të mbi 50% të kapitalit të aksioneve të asi lloj korporate ose pronësi mbi 50% të interesave në asi lloj entiteti; ose*

*(2) ka marrëdhënie bashkëpunimi me Ofertuesin e mundshëm të ndërtuar përmes një instrumenti me shkrim që është ligjërish i detyrueshëm si (i) marrëveshje për pjesëmarrje të përbashkët, (ii) ndërmarrje në pronësi të përbashkët, ose (iii) ka kontratë për shërbime menaxheriale. Obligimet e palëve nën kësi lloj instrumenti të shkruar duhet qartësisht të (a) jenë të lidhura me Aktivitetin e kërkuar për biznes të post privatizimit të subjektit të ri; (b) të krijoj shkallë materiale të përfshirjes për secilën palë në pajtim me normat e standardeve industriale të Aktiviteteve të kërkuara për biznes; (c) të theksojë premtimet e dhëna materiale nga secila palë në mbështetje të Aktiviteteve të parapara të biznesit të subjektit të ri; dhe (d) të theksojë angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë të secilës prej palëve në mbështetje të aktiviteteve të sipër përmendura nën (a), (b) dhe (c).*

Më 18 qershor 2012 Paditësi i parashtroi të Paditurës dokumentet për para-kualifikim dhe pasi që e Paditura me anë të letrës së datës 21 qershor 2012 (shih shkresat e lëndës, faqe 49) kishte kërkuar dokumente shtesë, Paditësi më 26 qershor 2012 parashtroi informacion dhe dokumente shtesë për para-kualifikim. Padia është referuar në lidhje me listën e detajuar të të gjitha dokumenteve të parashtruara nga ana e Paditësit (shih shkresat e lëndës, faqe 4 dhe 5).

Me anë të letrës së datës 29 qershor 2012 (shih shkresat e lëndës, faqe 51) Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e kualifikueshmërisë refuzoi kërkesën e Paditësit për përfshirje në listën e ofertueseve të pranueshëm, duke thënë se:

*“Në bazë të dokumenteve të parashtruara, Komisioni nuk ka arritur në një konstatim që është plotësuar kriteri i kërkuar në bazë të Rregullave të Tenderit”*

Paditësi e ka kundërshtuar këtë aktvendim dhe Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave i të Paditurës me anë të letrës së datës 10 korrik 2012 (shih shkresat e lëndës, faqe 56 dhe 57) e refuzoi ankesën, duke thënë:

.....

*“Në bazë të dokumentit të parashtruar nga [REDACTED] GmbH Company, Komisioni nuk ka qenë në gjendje që të arrijë një konstatim në lidhje me plotësimin e kriterit të kërkuar sipas Rregullave të Tenderit*

*Nuk është konfirmuar që Kompania Vartëse ka dëshmuar përvojë në zhvillimin, menaxhim dhe operacione me hotele dhe/ose Qendra ILIXHE dhe minimum 20% të të ardhurave duhet të vijnë nga aktivitetet e ILIXHES për së paku tri vite të njëpasnjëshme.*

.....

*Për sa i përket kompanisë në fjalë, nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion, i cili konfirmon lidhjen ligjore në mes të [REDACTED] GmbH Company dhe kompanive [REDACTED] dhe [REDACTED] GmbH.*

.....

*Megjithatë në bazë të Rregullave të Tenderit, neni 7.13 Vendimi i Menaxhmentit mund të atakohet në Dhomën e Posaçme*

Më 6 nëntor 2012 Paditësi parashtroi një padi pranë DHPGJS-së duke kundërshtuar këtë Vendim. Paditësi deklaroi se ka parashtruar të gjitha dokumentet e nevojshme të kërkuara me anë të Rregullave të Tenderit në mënyrë që të vërtetojë se posedon përvojën e nevojshme dhe mjetet financiare. Paditësi thekson se vendimi është i pabazuar dhe kërkon që të shpallet i pavlefshëm. Më tej, Paditësi kërkon që e Paditura të shpalos informata në lidhje me ato që kandidatët e tjerë kanë parashtruar për para-kualifikim dhe, nëse e Paditura refuzon të veprojë në këtë mënyrë për arsye të konfidencialitetit, që t'i paraqes informacion të tillë gjykatës “in camera”. Paditësi gjithashtu kërkon që gjykata, nëse konstaton se paditësi ka vepruar sipas rregullave të tenderit, të

urdhërojë ri-tenderimin, duke deklaruar se paditësi është i para-kualifikuar. Ai më tej kërkon që gjykata të urdhërojë ri-tenderimin edhe nëse asnjë ofertues nuk ka vepruar sipas rregullave të tenderimit apo nëse paditësi ka qenë i trajtuar në mënyrë të padrejtë. Paditësi kërkon që e Paditura të urdhërohet që të mos kryej shitjen me ofertuesin fitues të tenderit të fundit.

Paditësi pretendon se pas përjashtimit nga ofertimi i vetëm një ofertuesi, kishte ngelur mundësia e ofrimit të një çmimi më të ulët. Ai argumenton se e paditura është përpjekur që t'i shmanget një shitjeje garuese.

Me anë të mbrojtjes së saj të parashtruar pranë Dhomës së Posaçme më datë 3 dhjetor 2012 e Paditura kërkon që të refuzohet padia si e papranueshme ose si e pabazuar. E Paditura deklaron se në pajtim me nenin 4.1 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, pranë Dhomës së Posaçme mund të kundërshtohen vetëm vendimet e lëshuara nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, ndërsa në rastin në fjalë vendimi i kundërshtuar është lëshuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave. Sa i përket kundërshtimit të përzgjedhjes së ofertuesit fitues, e Paditura deklaron se një padi e tillë është e papranueshme, sepse aktualisht nuk ekziston asnjë Bord i Drejtorëve, i emëruar në Agjenci, prandaj asnjë prej 3 ofertuesve të para-kualifikuar nuk ishte përzgjedhur. E Paditura deklaron se procedura e tenderimit ka qenë ligjore, legjitime dhe është kryer në pajtim të plotë me rregullat e tenderit dhe Ligjin mbi AKP-në.

E Paditura konteston pretendimin se ka ajo ka anuluar ofertat me çmime më të larta ofertuese dhe se ka vazhduar procedurën me çmimet më të ulëta të ofertave. Ajo deklaron se Paditësi është ofertuesi i vetëm i diskualifikuar, ndërsa procedura ka vazhduar me 3 ofertues të tjerë.

Më 6 nëntor 2012 Paditësi parashtrroi një kërkesë për urdhër paraprak gjyqësor për të parandaluar AKP-në nga shitja e Ndërmarrjes së Re [REDACTED] [REDACTED] deri në gjykimin e plotë të padisë. Më 14 nëntor 2012 Kolegji i Specializuar 1 refuzoi Kërkesën për Urdhër Paraprak Gjyqësor si të pabazuar.

Shkresat e lëndës janë referuar sa i përket detajeve të tjera të parashtrësive të palëve.

## **Arsyetimi Ligjor**

Padia është e pranueshme.

Ashtu siç është përcaktuar në nenin 7.13 të Rregullave të Tenderit dhe nga e vetë e Paditura në letrën e saj të datës 10 korrik 2012, është deklaruar saktësisht

se vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave me anë të së cilit është diskualifikuar paditësi, mund të kundërshtohet pranë Dhomës së Posaçme.

Neni 4.1.1 që Dhoma e Posaçme ka juridiksion ekskluziv mbi lëndët që përfshijnë:

*“kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.*

Kolegji e kupton këtë dispozitë si një rregullore mbi juridiksionin, dhe jo si një rregullore në lidhje me çfarë mund të kundërshtohet në gjykatë.

Porse, e drejta për të kundërshtuar diskualifikimin rrjedh nga fakti se kjo nuk është vetëm një hap i brendshëm procedural i të paditurës, por një vendim me anë të së cilit përjashtohet paditësi nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në garë. Është në interesin e dukshëm të të dyja palëve që e drejta e paditësit për pjesëmarrje të jetë seriozisht e vlerësuar para përcaktimit të ofertuesit fitues. Me anë të kësaj përpjekjet e panevojshme për paditësin dhe të paditurën në procedurën e mëtutjeshme dhe vonesa në kohë janë shmangur. Në veçanti është shmangur ajo që vendimi përfundimtar i të paditurës duhet të kthehet mbi bazën që paditësi është diskualifikuar pa ndonjë justifikim.

Padia nuk është e bazuar.

Në bazë të Rregullave të Tenderit, ligjshmëria dhe drejtësia e të cilave nuk është kundërshtuar nga paditësi, e paditura ka pasur të drejtë që të diskualifikojë paditësin.

1.

Sipas nenit 7.2 a) paditësi ose

*“ose Kompania Vartëse duhet të ketë përvojë në zhvillimin, menaxhim dhe operacione me hotele dhe/ose Qendra ILIXHE me një qarkullim vjetor minimal prej 3 (tre) milion EUR për se paku secilën nga 3 vitet e fundit dhe minimum 20% të ardhurave duhet të vijnë nga aktivitetet e ILIXHES për së paku tri vite të njëpasnjëshme”*

Vetë paditësi nuk ka pasur asnjë përvojë në hotele dhe/apo qendra të ilixheve. Ai gjithashtu nuk pretendon se kompanitë e tij vartëse [REDACTED], [REDACTED] apo [REDACTED] të posedojnë përvojë të tillë. Deri më tani ai vetëm i referohet menaxhmentit të [REDACTED] Klinik dhe [REDACTED].

Me anë të Provës Materiale Nr.13 të shkresave të lëndës (faqe 102 deri 110) ai parashtron në detaje:

a.

runs a GmbH, që është një asociacion i përbërë prej 10 spitaleve, me një qarkullim prej 40 milion eurove. Nëpërmjet kësaj kuptohet aktiviteti i që ka të bëjë me marketing dhe negocim gjeneron me 30 milion euro. Spitalet janë të pavarura dhe garojnë njëra me tjetrën. Asociacioni prezanton vetveten në fushat e administratës, marketingut dhe shpërndarjes në një mënyrë të njësuar si jashtë ashtu edhe brenda.

Gjykata konstaton se ky nuk është një pretendim i qëndrueshëm i veprimtarisë së spitaleve. i shërben këtyre spitaleve, por nuk operon me to. Më tej Paditësi bile as nuk pretendon që qarkullimi prej 40 milionësh, respektivisht prej 30 milionësh, i referohet një periudhe prej tre vitesh të njëpasnjëshme.

b.

, sipas Provës Materiale Nr.13 gjithashtu e ka edhe GmbH. Kjo mund të jap përvojë relevante, megjithatë Prova Materiale 3 nuk shpalos qarkullimin e kësaj kompanie. Kjo nënkupton gjithashtu se ky pretendim nuk është i mjaftueshëm.

Më tej neni 7.2a i Rregullave të Tenderit kërkon që përvoja të jetë e dëshmuar. Parashtrësia e informacionit me shkrim pa nënshkrim nuk konsiderohet dëshmi.

2.

Por, si do që të jetë, kontributi i nuk mund të numërohet në favor të paditësit. Lidhja në mes të paditësit dhe , siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Shërbimeve të Menaxhmentit (Prova Materiale 12, faqe 98 deri 101 i shkresave të lëndës nuk është i mjaftueshëm.

Neni 1 i Rregullave të Tenderit thotë:

***Kompania vartëse***” nënkupton cilëndo korporatë ose entitet biznesi të cilën:

.....

(2) *ka marrëdhënie bashkëpunimi me Ofertuesin e mundshëm të ndërtuar përmes një instrumenti me shkrim që është ligjërish i detyrueshëm si (i) marrëveshje për pjesëmarrje të përbashkët, (ii) ndërmarrje në pronësi të përbashkët, ose (iii) ka kontratë për shërbime menaxheriale. Obligimet e palëve nën kësi lloj instrumenti të shkruar duhet qartësisht të (a) jenë të lidhura me Aktivitetin e kërkuar për biznes të post privatizimit të subjektit të ri; (b) të krijoj shkallë materiale të përfshirjes për secilën palë në pajtim me normat e standardeve industriale të Aktiviteteve të kërkuara për biznes; (c) të theksojë premtimet e dhëna materiale nga secila palë në mbështetje të Aktiviteteve të parapara të biznesit të subjektit të ri; dhe (d)*

*të theksojë angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë të secilës prej palëve në mbështetje të aktiviteteve të sipër përmendura nën (a), (b) dhe (c).*

Marrëveshja e Shërbimeve të Menaxhmentit në një fjali të dytë thjeshtë deklaroi se paditësi është i interesuar që të menaxhojë kompaninë së bashku me stafin e [REDAKTUAR]. Kjo fjali nuk krijon asnjë detyrim ligjor për [REDAKTUAR], madje as edhe për paditësin. Pastaj nën pikën 8 të marrëveshjes thuhet se në rast se paditësi do ta merr Banjën e Pejës, stafi i [REDAKTUAR] do të ofrojë tërë ekspertizën dhe përvojën e anëtarëve të saj, si dhe të partnerëve dhe vartësve për menaxhimin dhe operimin e ndërmarrjes. Kjo fjali nuk thekson ndonjë përfshirje, detyrimet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

Prandaj, e paditura nuk e ka shkelur të drejtën e paditësit duke e diskualifikuar atë nga tenderi dhe rrjedhimisht vendimi i datës 10 korrik 2012 nuk shpallet i pavlefshëm.

Paditësi gjithashtu në këtë fazë të procedurës së tenderimit nuk ka asnjë të drejtë të kërkojë që e paditura t'i shpalos atij apo gjykatës informacion në lidhje me çfarë kandidatët e tjerë kanë parashtruar për para-kualifikim. Gjykata nuk duhet dhe nuk mundet që të bëjë inspektimin tani (*in camera*). Gjithashtu as parashtruesi e paditësit nuk e justifikon urdhrin që e paditura të mos ia shes atë ofertuesit fitues dhe të shpall një tender të ri. Për të gjitha këto kërkesa paditësi nuk ka përmendur asnjë bazë ligjore dhe nuk ka asnjë bazë ligjore.

### **Shpenzimet e Gjykatës**

Gjykata nuk cakton shpenzimet e gjykatës pasi që presidiumi i gjykatës deri më tani nuk ka lëshuar një listë me shkrim të aprovuar nga Këshilli gjyqësor i Kosovës (Neni 57 Paragrafi 2 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), Kjo do të thotë se deri më tani nuk asnjë bazë të mjaftueshme për caktimin e shpenzimeve gjyqësore

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij aktgjykim mund të parashtrohet Ankesë. Ankesa e tillë mund të parashtrohet brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor nga Ankuesi brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktgjykim me shkrim.

**Kolegji i Apelit do ta refuzojë ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.**

E Paditura mund të ushtrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk,  
Gjyqtar Kryesues

[nënshkruar]